



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE**

---

<b>Numri i Ceshtjes :</b>	31025-04615-80-2015	<b>Data e Regjistrimit :</b>	16/07/2015
<b>Numri i Vendimit:</b>	80-2015-4063	<b>Data e Vendimit :</b>	16/11/2015

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

**GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PËRBËRË NGA:**

**GJYQTAR:** Gentian Hamiti

**SEKRETARE:** Entela Shkreta

Sot më datë 16/11/2015mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile që i përket :

Paditës Namik Dokle , i biri i dhe i , i datëlindjes 03/03/1946 I Paditur KUVENDI I SHQIPERISE

**Objekti:**Detyrimi i Kuvendit te, paguaj te gjitha perfitimet financiare qe burojne nga legjislacioni per “ Statusin e Deputetit “ dhe qe lidhen me ushtrimin e funksionit ,per periudhen Shtator 2009- Maj 2010

**Baza Ligjore:**ligji 49/2012 ligjit 8550 date 18.11.1999 “ Statusi i Deputetit i ndryshuar , ligjin Nr 10160 date 15.10.2009” Per rregullimin e sherbimit te transportit per funksionaret publike dhe nenpunesit civil “Vendimin nr 68 date 20.02.2003”Per menyren e trajtimit te deputeteve “ dhe vendimin nr 20 date 10.12.2009”Per percaktimin e mases se perfitimit financiar mujor per shperblimin e transportit te deputeteve “per periudhen Shtator 2009-Maj 2010

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në prani të palëve, gjykata si dëgjoji paditësin i cili kërkoi pranimin e padisë, palën e paditur e cila kërkuan rrëzimin e padisë, pasi shqyrtoi provat e bisedoi çështjen në tërësi:

**VEREN :**

## Vëren:

Se paditësi Namik Dokle ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesë padinë me objekt; Detyrimi i Kuvendit të paguaj të gjitha perfitimet financiare që burojnë nga legjislacioni për "Statusin e Deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit për periudhën Shtator 2009- Maj 2010.

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se me vendimin nr.538 datë 09.07.2009 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, paditësi është shpallur kandidat fitues nga lista shumë emërore e subjektit zgjedhor "Partia Socialiste" për Qarkun e Tiranës, duke fituar mandatin si deputet i legjislaturës së XVIII të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Sipas shkresës nr.906 prot datë 02.04.2010 të Sekretarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Namik Dokle ka bërë betimin në datë 25.02.2010.

Paditësi ka pretenduar se nga administrata e Kuvendit nuk i janë paguar detyrimet financiare që burojnë nga Kushtetuta dhe ligji "Statusi i Deputetit", për periudhën Shtator 2009-Maj 2010. Në këto kushte i është drejtuar gjykatës duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se: në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin "Statusi i Deputetit" dhe vendimet e Kuvendit, pala e paditur nuk ka bërë pagimin e detyrimeve financiare për periudhën shtator 2009-maj 2010.

Pala e paditur në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se: marrëdhëniet e konfliktit financiar kanë ardhur si pasojë e bojkotit të plotë nga deputeti i Partisë Socialiste që z. Dokle i ka bërë punës së Kuvendit duke mos marrë pjesë në seancat plenare, mbledhjet në komisionin e përhershëm parlamentar dhe veprimtari të tjera parlamentare; ndalesa në pagë ka ardhur si rezultat i mospjesmarrjes totale në veprimtarinë parlamentare.

Lidhur me bazueshmërinë e kërtimeve të paditësit, gjykata i referohet Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ligjit 8550 datë 18.11.1999 "Statusi i Deputetit" i ndryshuar, si dhe vendimeve që kanë dalë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për trajtimin financiar të deputetëve.

Sipas pikës 1 të nenit 71 të Kushtetutës, mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve. Para fillimit të ushtrimit të mandatit deputetët bëjnë betimin në Kuvend (neni 72 i Kushtetutës).

Rregulla më të detajuara, lidhur me verifikimin e mandateve të deputetit dhe betimin e tyre, parashikon Rregullorja e Kuvendit. Konkretisht në neni 4 të saj parashikohet se: *1. Menjëherë pas verifikimit të mandateve deputetët ftohen të bëjnë betimin.*

Krahas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, statusi i deputetit gjen rregullim nga ligji Nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i Deputetit". Në nenin 2 të këtij ligji parashikohet se:

*1. Deputeti i Kuvendit gëzon status të veçantë gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të deputetit, status që buron nga Kushtetuta dhe nga ligjet.*

*2. Me status të deputetit kuptohet pozicioni që ka ai në marrëdhëniet juridike, në marrëdhëniet me organet administrative shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore, si dhe të drejtat dhe detyrimet financiare dhe protokollare.*

Ndërsa të drejtat dhe detyrimet financiare të deputetit, gjejnë rregullim pikërisht nga dispozitat e ligjit Nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i Deputetit" si dhe nga vendimet e Kuvendit, të dala në zbatim të këtij ligji.

Sipas nenit 13 të ligjit Nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i Deputetit" paga e deputetit ka referenc me pagën e ministrit. Konkretisht në pikën 1 të këtij neni parashikohet; *1. Në klasifikim paga e deputetit vjen menjëherë pas pagës së ministrit, paga e Kryetarit të Kuvendit menjëherë pas pagës së Presidentit të Republikës dhe ajo e zëvendëskryetarëve barazohet me zëvendës-kryeministrin. 2. Paga e deputetit përbëhet nga paga për pjesëmarrjen e tij në seancë, në komisione dhe në veprimtari të tjera parlamentare.*

Përvec pagës, deputeti përfiton dieta gjatë kohës që merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit. Ky përfitim financiar gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 14 të ligjit Nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i Deputetit" në të cilën parashikohet se: *"1. Deputeti që nuk banon në qytetin e Tiranës përfiton dieta gjatë kohës që merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit, të komisioneve të mbledhjet të grupit parlamentar, ndërsa deputetët që banojnë në Tiranë përfitojnë dieta për ditët e shërbimit jashtë Tiranës. Modalitetet e përfitimit të dietave rregullohen me vendim të Kuvendit".*

Në vijim të këtij parashikimi ligjor, me vendimin nr.69 datë 20.02.2003 të Kuvendit është përcaktuar se deputeti shpërblehet për pjesëmarrjen në mbledhje të komisionit të përhershëm ku bën pjesë në shumën 2000 lekë si dhe 6 ditë dietë në muaj deputetëve që banojnë në qytetin e Tiranës.

Ndërsa neni 19 i ligjit Nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i Deputetit", i njeh të drejtën deputetit të pajiset me shërbim telefonik, vlefata e shpenzimeve përcaktohet me vendim të Kuvendit. Në këtë nen parashikohet: *"Deputeti pajiset me shërbim telefonik. Vlefata e shpenzimeve për shërbimet e telekomunikacionit përcaktohet me vendim të Kuvendit.*

Vlera e këtij shërbimi përcaktohet nga pika IV e Vendimit nr.68 datë 20.02.2003 e Kuvendit "Për

Miratimin e Trajtimit të Deputetëve”, sipas së cilës, deputetëve u paguhet për shërbime telefonike 17000 lekë në muaj.

Nga nxjerrja e llogarisë bankare rezulton se paditësi nuk është trajtuar financiarisht nga administrata e Kuvendit për periudhën shtator 2009 deri në datën e betimit si deputet (shkurt 2010)

Sipas pikës 1 të nenit 71 të Kushtetutës, mandati i deputetit të z.Namik Dokle ka filluar në datën që është shpallur i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve, konkretisht datë 01.08.2009, në të cilën është marrë vendimi nr.538 datë 09.07.2009 i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Pra në këtë datë, paditësit i kanë lindur të drejtat financiare me administratën e Kuvendit, kjo, mbështetur në nenin 13 e vijues të ligjit Nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i Deputetit”.

Duke qenë se paditësit nuk i është paguar paga për periudhën shtator 2009 – shkurt 2010, si dhe një pjesë e përfitimeve financiare për periudhën shtator-maj 2010, atëherë kërkimi i tij për pagimin e pagës dhe përfitimeve financiare është i bazuar në nenin 13 të ligjit Nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i Deputetit”. Sipas llogaritjeve përkatëse, vlera e pagës neto që detyrohet pala e paditur t’i paguajë paditësit është në shumën 780.243 lekë.

Nga paditësi është kërkuar pagimi i kontributeve në skemën e sigurimeve suplementare për periudhën shtator 2009 – maj 2010.

Sipas nenit 20 të ligjit Nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i Deputetit”: *1. Deputeti përfiton të drejtën e pagesës kalimtare dhe të pensionit suplementar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme dhe ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit" me plotësimet e mëvonshme.*

Në këndvështrim të kësaj dispozite, paditësi në cilësinë e deputetit, ka të drejtën që t’i derdhen në skemën e sigurimeve shoqërore kontributet përkatëse për periudhën shtator 2009 – maj 2010.

Përsa i përket kërkimit për pagimin e dietave, gjykata i referohet pikës 1 të nenit 14 të ligjit Nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i Deputetit” në të cilin parashikohet se: *"1. Deputeti që nuk banon në qytetin e Tiranës përfiton dieta gjate kohës që merr pjese në mbledhjet e Kuvendit, të komisioneve të mbledhjet e grupit parlamentar, ndërsa deputetët që banojnë në Tiranë përfitojnë dieta për ditët e shërbimit jashtë Tiranës. Modalitetet e përfitimit të dietave rregullohen me vendim të Kuvendit.*

Modalitetet e këtij përfitimi janë rregulluar me vendimin nr.69 datë 20.02.2003 të Kuvendit, në të cilin është përcaktuar se deputeti që banon në qytetin e Tiranës dhe e ka zonën elektorale jashtë Tiranës, përfiton 6 ditë dietë në muaj. Ka rezultuar se paditësi është shpallur deputet i Qarkut të Tiranës, ndërsa qendra elektorale e tij ka qenë Bashkia Kamzës. Sipas përlllogaritjeve, vlera e përfitimit të papaguar për dieta është në shumën 272282 lekë.

Po kështu, sipas nenit 19 të ligjit Nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i Deputetit”, deputetit i njihet e drejta të pajiset me shërbim telefonik. Në këtë nen parashikohet: *"Deputeti pajiset me shërbim telefonik. Vlefte e shpenzimeve për shërbimet e telekomunikacionit përcaktohet me vendim të Kuvendit.*

Në pikën IV të vendimit nr.68 datë 20.02.2003 të Kuvendit Për Miratimin e Trajtimit të Deputetëve, është përcaktuar se deputetëve u paguhet për shërbime telefonike 17000 lekë në muaj. Duke qenë se kjo e drejtë financiare nuk i është përmbushur paditësit nga Kuvendi, atëherë gjykata cmon se kërkimi i paditësit për pagimin e shërbimeve telefonike, që sipas përlllogaritjeve është në vlerën 147.100 lekë, është i bazuar.

Me vendimin nr.20 datë 10.12.2009 të Kuvendit është përcaktuar masa e përfitimit financiar mujor për shërbimin e transportit të deputetëve. Duke iu referuar këtij vendimi, vlera e karburantit që i njihet paditësit rezulton të jetë në shumën 223042 lekë. Ky vendim ka dalë në bazë të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë".

Duke qenë se ky përfitim nuk i është paguar paditësit, atëherë gjykata cmon se Kuvendi ka detyrimin për të përmbushur detyrimin financiar ndaj paditësit në shumën 223042 lekë.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, gjykata arrin në konkluzionin se padia e paraqitur prej paditësit duhet pranuar si e bazuar në prova dhe në ligj duke u detyruar pala e paditur ti paguaj vlerën e pagës neto të papaguar në shumën 780.243 lekë, shpenzimet telefonike në shumën 147.100 lekë, pagimin e dietave në shumën 272282 lekë, shpenzimet e transportit në shumën 223042 lekë, si dhe të paguajë kontributet në skemën e sigurimeve suplementare për periudhën shtator 2009 – maj 2010.

### **Për këto arsye**

#### **Baza Ligjore:**

Gjykata, bazuar në nenet 40, 41, 42 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 “Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Adminisrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”, nenet 306-310 të K.Pr.Civile.

### **VENDOSI:**

Vendosi:

- Pranimin e padisë.
- Detyrimin e të paditurit t'i paguaj paditësit përfitimet e papaguara (pagën + shpenzime telefonike + pagim dieta + shpenzime transporti), totali në shumën 1.422,667 (një milion e katërqind e njëzet e dymijë gjashtëqind e gjashtdhjetë e shtatë) lekë.
- Detyrimin e të paditurit t'i paguajë paditësit kontributet në skemën e sigurimeve suplementare për periudhën shtator 2009 – maj 2010.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit.
- Ky vendim gjyqësor është i ekzekutueshëm nga Zyra Përmbartimore.
- Ngarkohet Zyra Përmbartimore të ekzekutojë plotësisht detyrimin nga dita që vendimi të marrë formë të prerë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit ndërsa për palën në mungesë ky afat fillon nga e nesërmja e marrjes dijeni.
- U shpall sot më datë 16.11.2015, Tiranë.

### **SHPENZIMET GJYQESORE**

<b>Kërkesëpadia</b>	0
<b>Taksa Gjyqësore</b>	0
<b>Noterizime</b>	0
<b>Njoftime</b>	0
<b>Akt ekspertimi</b>	0
<b>Avokat</b>	0
<b>Gjithsej</b>	0

**GJYQTAR:**

**Gentian Hamiti**